




Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



Në mbështetje të nenit 47 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 05/L -042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, lidhur me Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 02/2016 për Standardet Minimale të Shërbimeve të ujit në Kosovë, Autoritetit Rregullator për Shërbime të Ujit,

Nxjerr:

Rregulloren Nr. 08/2018 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 02/2016 për Standardet Minimale të Shërbimeve të Ujit në Kosovë

Neni 1

Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim të ndryshojë dhe plotësojë Rregulloren Nr. 02/2016 për Standardet Minimale të Shërbimeve të Ujit në Kosovë.

Neni 2

Në nenin 24 të rregullores, paragrafi 2 riformulohet me tekstin si në vijim:

2. Instalimi i lidhjes së shërbimeve (gypit të lidhjes dhe ujëmatësit) bëhet nga ofruesi i shërbimeve. Në rast se punimi i lidhjes kryhet nga kontraktori i pavarur, një gjë e tillë duhet të bëhet nën mbikëqyrjen dhe pranimin teknik nga ofruesi i shërbimeve.

Neni 3

Në nenin 30 të rregullores, paragrafi 1 riformulohet me tekstin si në vijim:

1. Me qëllim të monitorimit të sasisë së përpunimit të ujit të pijshëm dhe ujërave të ndotura, ofruesi i shërbimeve duhet të instalojë pajisje të përshtatshme për matjen e ujit në:
 - 1.1. dalje të fabrikës së përpunimit të ujit të pijshëm,
 - 1.2. hyrje të fabrikës së përpunimit të ujërave të ndotura.

Neni 4

Në nenin 30 të rregullores, paragrafi 3 riformulohet me tekstin si në vijim:

3. Ofruesi i shërbimeve duhet të instalojë ujëmatës kryesor (të përbashkët) në ndërtesat e banimit kolektiv, me qëllim të monitorimit të sasisë së shpërndarë të ujit të pijshëm.

Neni 5

Në nenin 32 të rregullores, paragrafi 1, fshihet.

Neni 6

Në nenin 32 të rregullores, paragrafi 3, riformulohet me tekstin si në vijim:

3. Leximi i ujëmatësit duhet të bëhet brenda orarit dhe ditëve të punës së ofruesit të shërbimeve, përderisa konsumatori duhet të i mundësojë lexuesit të ujëmatësit qasjen tek ujëmatësi brenda këtij orari.

Neni 7

Në nenin 33 të rregullores, paragrafi 4, riformulohet me tekstin si në vijim:

4. Ujëmatësi i nënshtrohet zëvendësimit në rast se testi i verifikimit të ujëmatësit tregon se gabimi në matje e tejkalon devijimin standard të përcaktuar nga Agjencia e Metrologjisë së Kosovës.

Neni 8

Në nenin 34 të rregullores, paragrafi 1, riformulohet me tekstin si në vijim:

1. Përpos në rastet kur është përcaktuar ndryshe me këtë Rregullore, ofruesi i shërbimeve duhet të i faturojë konsumatorët në bazë të konsumit të lexuar në ujëmatës. Ofruesi i shërbimeve duhet të i dërgojë secilit konsumator një faturë për shërbimet e ujësjellësit dhe të ujërave të ndotura, për çdo muaj, më së largu deri në datën njëzet (20) të muajit aktual, për shërbimet e ofruara në muajin paraprak. Kjo rezulton me dymbëdhjetë (12) fatura në vjet.

Neni 9

Në nenin 34 të rregullores, pas paragrafit 1, shtohen paragrafët 2, 3 dhe 4, me tekstin si në vijim:

2. Të gjithë konsumatorët, të cilët aktualisht nuk kanë ujëmatës dhe faturohen pa ujëmatës janë të obliguar që në bashkëpunim dhe në bazë të udhëzimeve të ofruesit të shërbimeve të instalojnë ujëmatësin, me qëllim që faturimi të bëhet në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe kontratën e shërbimeve.
3. Në pajtim me Ligjin Nr. 05/L – 042 (neni 28 paragrafi 3), ofruesi i shërbimeve do të ndërpres ofrimin e shërbimeve për konsumatorët të cilët nuk kanë vepruar sipas dispozitës së paragrafit 2 të këtij neni përpos në rastet:
 - 3.1. kur është përcaktuar ndryshe me këtë Rregullore;
 - 3.2. e parapara me Nenin 27 paragrafin 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 05/L – 042.
4. Konsumatorët të cilët nga ofruesi i shërbimeve marrin vetëm shërbimet e ujërave të ndotura (nuk janë të lidhur në rrjetin e ujësjellësit të ofruesit të shërbimeve) do të faturohen në bazë të:
 - 4.1. leximit të sasisë së ujit të konsumuar të matur në ujëmatësin individual, në rastet kur ujëmatësi ekziston;
 - 4.2. një mostre përfaqësuese të matur të konsumatorëve të kategorisë së njëjtë.

Neni 10

Në nenin 35 të rregullores, paragrafi 2, riformulohet me tekstin si në vijim:

2. Në rastet kur ujëmatësi është jofunksional për çfarëdo arsye dhe faturimi nuk mund të bëhet në bazë të konsumit të lexuar në ujëmatës, faturimi për periudhën kohore derisa ujëmatësi është jofunksional, do të bëhet në bazë të vlerësimit të bërë nga ofruesi i shërbimeve, i cili vlerësim duhet të bazohet në konsumin e realizuar në periudhën paraprake korresponduese të atij konsumatori. Në këtë rast faturimi i bazuar në vlerësim nuk duhet të tejkalojë periudhën: (i) më tepër se tre (3) muaj për konsumatorët komercial dhe institucional; dhe (ii) më tepër se gjashtë (6) muaj për konsumatorët shtëpiak. Nëse pas kësaj periudhe konsumatori refuzon rregullimin e ujëmatësit apo instalimin e ujëmatësit të ri atëherë ofruesi i shërbimeve do të veprojë sipas paragrafit 3 të nenit 34 të kësaj Rregullore.

Neni 11

Në nenin 35 të rregullores, paragrafi 4, fshihet.

Neni 12

Në nenin 36 të rregullores, titulli, riformulohet me tekstin si në vijim:

“Faturimi në rastet pa ujëmatës në ndërtesat e banimit kolektiv”

Neni 13

Në nenin 36 të rregullores, paragrafi 1 dhe 2, riformulohen me tekstin si në vijim:

1. Në ndërtesat e banimit kolektiv në të cilat banojnë dy (2) e më tepër konsumatorë pa ujëmatës dhe nuk ekziston as ujëmatësi kryesor (i përbashkët), deri në përbushjen e obligimit të konsumatorit për instalimin e ujëmatësit individual, apo deri në përbushjen e obligimit të ofruesit të shërbimeve për instalimin e ujëmatësit të përbashkët, faturimi i këtyre konsumatorëve do të bëhet si në vijim:
 - 1.1. Në bazë të leximit të ujëmatësit individual, në ato raste kur ekziston ujëmatësi individual;
 - 1.2. Për konsumatorët shtëpiak (në ndërtesat e banimit kolektiv) pa ujëmatës:
 - 1.2.1. Ofruesit e Shërbimeve duhet të analizojnë konsumin e matur mujor mesatar të kategorisë së njëjtë (apartamente) në bazë të një mostre përfaqësuese ose të dhënave complete të faturimit;
 - 1.2.2. Rezultatet e analizimit duhet të i dorëzohen dhe do të i nënshtrohen për aprovim Autoritetit. Ofruesit e shërbimeve duhet të i mundësojnë Autoritetit qasjen në të gjitha analizat, kalkulimet etj., të ndërmarra gjatë përcaktimit të mesatares së konsumit të matur;
 - 1.2.3. Vëllimi i vlerësuar i konsumit mujor për qëllime të ngarkimit duhet të jetë 1.5 X (herë) ngarkimi mesatar i matur për atë kategori.
 - 1.3. Për konsumatorët komercial dhe institucional (në ndërtesat e banimit kolektiv) pa ujëmatës:
 - 1.3.1. Ofruesit e shërbimeve janë të lirë në përcaktimin e vlerësimeve të duhura të konsumit të ujit për secilën nën-kategori të konsumatorëve komercial dhe institucional;

1.3.2. Vëllimi i vlerësuar i konsumit mujor për qëllime të ngarkimit duhet të jetë 3 X (herë) ngarkimi mesatar i matur për atë kategori.

2. Në rastet kur konsumatori është pasiv, pa ujëmatës, faturimi do të bëhet si në paragrafin 1.2. dhe 1.3. të këtij Neni.

Neni 14

Në nenin 36 të rregullores, paragrafi 3, ndryshohet dhe zëvendësohet me tekstin si në vijim:

3. Ofruesi i shërbimeve në afat kohor prej gjashtë (6) muajve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Rregullore është i obliguar të instalojë ujëmatësit kryesor (të përbashkët) për ndërtesat e banimit kolektiv, konsumatorët e të cilëve nuk kanë ujëmatës individual.

Neni 15

Në nenin 36 të rregullores, paragrafi 4 dhe 5, fshihen.

Neni 16

Në nenin 37 të rregullores, paragrafi 1, riformulohet me tekstin si në vijim:

1. Në ndërtesat e banimit kolektiv në të cilat banojnë dy (2) e më tepër konsumatorë, ku faturimi për shpenzimet e ujit bëhet në bazë të konsumit ujit të lexuar në ujëmatësin kryesor (të përbashkët), mënyra e faturimit për ujin e konsumuar do të bëhet si vijim:

1.1. Në bazë të sasisë së ujit të lexuar në ujëmatësit individual, në ato raste kur ekziston ujëmatësi individual;

1.2. Deri në vendosjen e ujëmatësve individual, në rastet kur konsumi matet përmes ujëmatësit të përbashkët, apo kur teknikisht nuk është i mundur realizimi i ndarjes së lidhjes në mes të pronave të së njëjtës ndërtesë me qëllim të zbatimit të paragrafit 4 të Nenit 34 të kësaj Rregullore, atëherë konsumimi i përbashkët (sasia e ujit matur me m^3) i ndahet secilës pronë (konsumator) në bazë të numrit të anëtarëve të bashkësisë familjare. Bazë për përcaktimin e numrit të anëtarëve të bashkësisë familjare merret:

1.2.1 Lista me numrin e anëtarëve të bashkësisë familjare e proceduar nga përfaqësuesi i ndërtesës kolektive, në pajtim me Ligjin për shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesës në bashkëpronësi. Lista konsiderohet e vlefshme kur është e nënshkruar nga konsumatorët e ndërtesës së banimit kolektiv. Lista mund të përditësohet varësisht nga risitë në bazë të kërkesës së konsumatorëve dhe ofruesit të shërbimeve;

1.2.2 Përlllogaritja e anëtarëve të bashkësisë familjare në bazë të sipërfaqes së pronës, sipas normave të dimensionimit të hapësirës së banimit. Në këtë rast, hapësira e planifikuar banuese sipas normave fillon nga $40m^2$ sipërfaqe të pronës për 1 (një) banor dhe shtohet 1 (një) banor për çdo $12 m^2$ sipërfaqe shtesë të pronës.

1.3. Mënyra e faturimit për këtë kategori të konsumatorëve (në bazë të numrit të anëtarëve të bashkësisë familjare) bëhet si në vijim:

1.3.1. Llogaritjet konsumi për 1 banor (m^3) (sasia e ujit të matur (m^3) në ujëmatësin e përbashkët ndahet/pjesëtohet për numrin e përgjithshëm të banorëve);

1.3.2. Për llogaritja e faturimit bëhet duke marrë për bazë: numri i banorëve për pronë X (herë) konsumimi i llogaritur për banor (m^3) X (herë) tarifa për kategorinë përkatëse, gjegjësisht konsumatorët shtëpiak ngarkohen me tarifë shtëpiake, ndërsa ata komercial dhe institucional me tarifë jo-shtëpiake.

1.4. Përveç kontratës së shërbimit, Ofruesi i shërbimeve me konsumatorët të cilët faturohen sipas nënparagrafit 1.2 të këtij neni duhet të nënshkruajë edhe marrëveshjen e pajtueshmërisë me këtë formë të faturimit.

Neni 17

Në nenin 37 të rregullores, paragrafi 2 dhe 3, fshihen.

Neni 18

Kjo Rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas datës së nënshkrimit.

Datë 10.04. 2018
Prishtinë

